

URDHËR
Nr. 122, datë 6.3.2023

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PRAKTIKAT UNIFORME NË KRYERJEN E KONTROLLEVE MBI PËRDORIMIN E SUBSTANCAVE FARMAKOLOGJIKISHT AKTIVE TË AUTORIZUARA SI PMV OSE SI ADITIVË PËR USHQIMET E KAFSHËVE DHE MBETJEVE TË TYRE, MBI SUBSTANCAT FARMAKOLOGJIKISHT AKTIVE TË NDALUARA OSE TË PAAUTORIZUARA TË PËRDORURA NË KAFSHËT, QË PRODHONË USHQIM, MBETJET E TYRE, SI DHE PËR PËRMBAJTJEN SPECIFIKE TË PLANEVE TË KONTROLLIT DHE MËNYRAT E HARTIMIT TË TYRE, PËR ZBATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË MONITORIMIT TË MBETJEVE”¹

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, pikës 3 të nenit 81, pikës 8 të nenit 102, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Për miratimin e rregullave për praktikat uniforme në kryerjen e kontrolleve mbi përdorimin e substancave farmakologjikisht aktive të autorizuar si PMV ose si aditivë për ushqimet e kafshëve dhe mbetjeve të tyre, mbi substancat farmakologjikisht aktive të ndaluara ose të paautorizuara të përdorura në kafshët që prodhojnë ushqim, mbetjet e tyre, si dhe për përmbajtjen specifike të planeve të kontrollit dhe mënyrat e hartimit të tyre, për zbatimin e planit kombëtar të monitorimit të mbetjeve”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

¹ Ky urdhër përaftron rregulloren ekzekutive (BE) 2022/1646 e Komisionit, datë 23 shtator 2022, për sa u përket mënyrave praktike uniforme të kryerjes së kontrolleve zyrtare, përdorimit të substancave farmakologjikisht aktive të autorizuar, si medikamente veterinarë ose si aditivë për ushqimet e kafshëve dhe të mbetjeve të tyre, përdorimit të substancave farmakologjikisht aktive të ndaluara ose të paautorizuara dhe të mbetjeve të tyre, si dhe përmbajtjes specifike të planeve kombëtare shumëvjeçare të kontrollit dhe mënyrave specifike për hartimin e tyre. CELEX numër: 32022R1646, Gazeta Zyrtare L 248, faqe 32.

RREGULLORE

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PRAKTIKAT UNIFORME NË KRYERJEN E KONTROLLEVE MBI PËRDORIMIN E SUBSTANCAVE FARMAKOLOGJIKISHT AKTIVE TË AUTORIZUARA SI PMV OSE SI ADITIVË PËR USHQIMET E KAFSHËVE DHE MBETJEVE TË TYRE, MBI SUBSTANCAT FARMAKOLOGJIKISHT AKTIVE TË NDALUARA OSE TË PAAUTORIZUARA TË PËRDORURA NË KAFSHËT QË PRODHOJNË USHQIM, MBETJET E TYRE, SI DHE PËR PËRMBAJTJEN SPECIFIKE TË PLANEVE TË KONTROLLIT DHE MËNYRAT E HARTIMIT TË TYRE, PËR ZBATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË MONITORIMIT TË MBETJEVE

KAPITULLI I LËNDA, QËLLIMI DHE PËRKUFIZIMET

Neni 1

Lënda

Për qëllimet e kontrolleve zyrtare mbi përdorimin e substancave farmakologjikisht aktive të autorizuar si produkte mjekësore veterinarë ose si aditivë për ushqimet e kafshëve dhe të substancave farmakologjikisht aktive të ndaluara ose të paaautorizuara dhe mbetjeve të tyre, kjo rregullore përcakton:

- a) frekuencën minimale të kampionimit uniforme vjetore si pjesë e kontrolleve zyrtare, duke mbajtur parasysh rreziqet dhe riskun e lidhur me substancat në fjalë;
- b) mënyrat specifike të hartimit dhe përmbajtjet specifike të planeve kombëtare të kontrollit të mbetjeve.

Neni 2

Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj rregulloreje zbatohen përkufizimet e ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar, si dhe urdhrit nr. 85, datë 17.2.2023².

KAPITULLI II PËRMBAJTJE SPECIFIKE SHITESË TË PLANEVE KOMBËTARE TË KONTROLLIT TË MBETJEVE

Neni 3

Dispozita të përgjithshme

Struktura Përgjegjëse për Veterinarinë (SPV) merr masa me qëllim që pjesa e planeve kombëtare të kontrollit të mbetjeve që i përket kryerjes së kontrolleve mbi përdorimin e substancave farmakologjikisht aktive të autorizuar si Produkte Mjekësore Veterinarë (PMV) ose si aditivë për ushqimet e kafshëve dhe të substancave farmakologjikisht aktive të ndaluara ose të paaautorizuara dhe mbetjeve të tyre në kafshët e gjalla dhe në produktet me origjinë shtazore të përmbajnë sa vijon:

- a) një “plan kombëtar kontrolli bazuar në risk për prodhimin në vend”, sipas parashikimeve të nenit 4 të kësaj Rregulloreje;

² Për miratimin e rregullores “Për kontrollin zyrtar mbi përdorimin e substancave farmakologjikisht aktive të autorizuar si produkte mjekësore veterinarë ose si aditivë për ushqimet për kafshë dhe mbetjet e tyre, si dhe mbi përdorimin e substancave farmakologjikisht aktive të ndaluara, që përdoren në kafshët që prodhojnë ushqim dhe mbetjet e tyre, për zbatimin e planit kombëtar të monitorimit të mbetjeve”.

b) një “plan kombëtar të mbikëqyrjes së rastësishme për prodhimin në vend”, sipas kërkesave të nenit 5 të kësaj Rregulloreje;

c) një “plan kombëtar kontrolli bazuar në risk për importet nga vendet e treta”, sipas parashikimeve të nenit 6 të kësaj Rregulloreje.

Neni 4

Plani Kombëtar i Kontrollit bazuar në risk për prodhimin në vend

SPV harton një plan kombëtar të kontrollit bazuar në risk për substancat e grupeve A dhe B, sipas përshkrimeve të aneksit I, të urdhrit të ministrit nr. 85, datë 17.2.2023, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së kafshëve, që prodhojnë ushqim dhe të produkteve me origjinë shtazore të prodhuara në vend me legjislacionin i cili rregullon përdorimin e substancave farmakologjikisht aktive të autorizuar si PMV ose si aditivë për ushqimet e kafshëve dhe të substancave farmakologjikisht aktive të ndaluara ose të paaautorizuara dhe mbetjeve të tyre, limitet maksimale të mbetjeve dhe nivelet maksimale të zbatuara në ushqime.

Plani kombëtar i kontrollit të prodhimit bazuar në risk përmban elementet që vijojnë:

a) listën e kombinimit të llojeve të kafshëve dhe të substancave, produkteve dhe matricave sipas përshkrimeve të aneksit II, të urdhrit të ministrit nr. 85, datë 17.2.2023;

b) strategjinë e kampionimit të vendosur nga SPV në përputhje me kërkesat e aneksit III, të urdhrit të ministrit nr. 85, datë 17.2.2023;

c) frekuencën e kampionimit duke mbajtur parasysh frekuencat minimale të kontrollit vjetor, sipas përshkrimeve të aneksit I;

ç) metodat analitike që do të përdoren dhe karakteristikat e rendimentit të tyre;

d) informacione të hollësishme sipas parashikimeve të nenit 7, paragrafët 1 dhe 2.

SPV rishikon planin kombëtar të kontrollit bazuar në risk për prodhimin në vend për të mbajtur parasysh trajtimet e jashtëligjshme të gjetura, në veçanti trajtimet e jashtëligjshme të gjetura gjatë zbatimit të planit të mbikëqyrjes së rastësishme.

Neni 5

Plani kombëtar i mbikëqyrjes së rastësishme për prodhimin në vend

SPV-ja harton një plan kombëtar të mbikëqyrjes së rastësishme për kontrollin e prodhimit, i cili garanton një monitorim të rastësishëm për një gamë të gjerë të substancave.

Plani kombëtar i mbikëqyrjes së rastësishme të prodhimit përfshin elementet që vijojnë:

a) listën e kombinimit të substancave dhe të llojeve të kafshëve, produkteve dhe matricave sipas përshkrimeve të aneksit IV, të urdhrit të ministrit nr. 85, datë 17.2.2023;

b) strategjinë e kampionimit, në përputhje me aneksin V, të urdhrit të ministrit nr. 85, datë 17.2.2023;

c) frekuencat e kampionimit që do të kryhet, vendosen nga SPV-ja duke mbajtur parasysh frekuencat minimale të kampionimit, të përshkruara në këtë rregullore;

ç) informacione të hollësishme sipas parashikimeve të nenit 7, pika 1;

Në përputhje me kërkesat që u përkasin metodave analitike, për analizimin e substancave farmakologjikisht aktive të autorizuar si PMV ose si aditivë për ushqimet e kafshëve dhe të substancave farmakologjikisht aktive të ndaluara ose të paaautorizuara dhe mbetjeve të tyre në produktet me origjinë shtazore, të cilat japin rezultate sasiore ose gjysmësasiore, edhe kur këto mbetje identifikohen në nivele më të ulëta se limiti maksimal i mbetjeve.

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë informon SPV dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve mbi rezultatet analitike për zbulimin e substancave të autorizuar, duke siguruar raportimin e të gjitha përqendrimeve në ose mbi aftësinë e zbulimit për *screening* (“CCβ”) të metodës, duke siguruar CCβ më të ulët që përftohet nga metodat, që përdoren për kryerjen e analizave *screening*. Për

testimin e kryer vetëm me metoda konfirmuese, do të raportohen të gjitha rezultatet e matshme. Në rast të përdorimit të metodave të *sceening* të synuar dhe jo të synuar, ISUV raportojnë mbi përdorimin dhe gjetjet e këtyre metodave analitike.

Neni 6

Plani kombëtar i kontrollit bazuar në risk për importet nga vendet e treta

SPV-ja harton një plan kombëtar të kontrollit bazuar në risk për kafshët që prodhojnë ushqim dhe produkteve me origjinë shtazore që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet pikave të kontrollit kufitar, sipas kërkesave të legjislacionit mbi kontrollet mbi produktet shtazore, me qëllim verifikimin e kërkesave ligjore mbi përdorimin e substancave farmakologjiksht aktive të listuara në aneksin I, të urdhrit të ministrit nr. 85, datë 17.2.2023, dhe përputhshmërisë me MRL-të dhe ML-të e aplikueshme në vend.

Kontrollet mbi përdorimin e substancave farmakologjiksht aktive të autorizuar si PMV ose si aditivë për ushqimet e kafshëve dhe të substancave farmakologjiksht aktive të ndaluara ose të paaautorizuara dhe mbetjeve të tyre, kryhen në kuadrin e inspektimit në pikat e kontrollit kufitar ose në destinacionin përfundimtar.

Plani kombëtar i kontrollit bazuar në risk të importeve nga vendet e treta përfshin elementet që vijojnë:

- a) listën e kombinimit të llojeve të kafshëve dhe substancave, produkteve dhe matricave sipas përshkrimeve të aneksit VI, të urdhrit të ministrit nr. 85, datë 17.2.2023;
- b) strategjinë e kampionimit në përputhje me aneksin VII, të urdhrit të ministrit nr. 85, datë 17.2.2023;
- c) frekuencat e kampionimit të kryer në pikat e kontrollit kufitar, duke marrë parasysh frekuencat minimale të kampionimit, sipas përshkrimeve të aneksit II të kësaj rregulloreje. Kampionet e marra për qëllimet e kontroleve zyrtare të kryera për shkak të dyshimit për përputhshmëri në pikat e kontrollit kufitar nuk konsiderohen kampione që kontribuojnë në përllogaritjen e frekuencave minimale të kampionimit sipas përshkrimeve të aneksit II të kësaj rregulloreje;
- ç) metodat analitike që do të përdoren dhe karakteristikat e performancës së tyre;
- d) informacione të hollësishme sipas parashikimeve të nenit 7, pika 1 dhe 2.

Neni 7

Përmbajtja shtesë e planeve kombëtare të kontrollit të bazuar në risk dhe planit të rastësishëm të mbikëqyrjes

1. Planet kombëtare të kontrollit të bazuar në risk sipas përshkrimeve të nenet 4 dhe 6 dhe planit kombëtar i mbikëqyrjes së rastësishme, sipas parashikimeve të nenit 5 përcaktojnë informacionet, që vijojnë:

- a) informacione të hollësishme mbi llojet e kafshëve të cilat do t'i nënshtrohen kampionimit dhe informacione mbi vendin e kampionimit;
- b) informacione mbi legjislacionin kombëtar që i përket përdorimit të substancave farmakologjiksht aktive dhe në veçanti për ndalimin ose autorizimin, shpërndarjen dhe vendosjen në treg të tyre dhe rregullave të administrimit të këtyre substancave, në atë masë në të cilën legjislacioni në fjalë nuk është i harmonizuar;
- c) informacione mbi autoritetet kompetente përgjegjëse për zbatimin e planeve;
- ç) llojet e masave të ndjekjes së rasteve të pa përputhshmërisë (*follow-up*) të marra nga autoritetet kompetente, në lidhje me kafshët ose produktet me origjinë shtazore, në të cilat janë gjetur mbetje në vitet e mëparshme.

2. Planet kombëtare të kontrollit të bazuar në risk, sipas përshkrimeve të neneve 4 dhe 6, përveç informacioneve të përshkruara nga paragrafi 1, përfshijnë edhe sa vijon:

a) një argumentim për substancat, llojet e kafshëve, produktet dhe matricat e përzgjedhura dhe të përfshira në plane mbi bazën e kriterëve të listuara në Anekset II dhe VI, të Urdhrit të Nr. 85, datë 17.2.2023, duke përfshirë një argumentim të mënyrës në të cilën janë mbajtur parasysh kriteret e listuara në anekset e sipërpërmendura edhe kur nuk janë bërë ndryshime përkundrejt planit të vitit paraardhës;

b) një argumentim në mënyrën në të cilën janë mbajtur parasysh, me qëllim përmirësimin e planit, informacionet e marra nga një analizë e përgjithshme e rasteve të papërputhshmërive, në vend gjatë tri vitetve të fundit kalendarike.

KAPITULLI III

DORËZIMI DHE VLERËSIMI I PLANEVE DHE DORËZIMI I TË DHËNAVE NGA SHQIPËRIA

Neni 8

Dorëzimi dhe vlerësimi i planeve të kontrollit

Deri më 31 mars të çdo viti, Shqipëria i paraqet Komisionit Evropian (KE), planet kombëtare të kontrollit të bazuara në risk dhe planin e mbikëqyrjes së rastësishme për vitin aktual kalendarik, të rishikuara dhe të përditësuara në mënyrë elektronike.

Shqipëria i paraqet KE versionet e përditësuara të planeve përkatëse, duke përshkruar se si janë marrë parasysh komentet e KE, deri më 31 mars të vitit pasardhës. Kur Shqipëria vendos të mos përditësojë planet e kontrollit bazuar në komentet e KE, ajo duhet të arsyetojë pozicionin e saj.

Neni 9

Dorëzimi i të dhënave nga Shqipëria

Deri më 30 qershor të çdo viti Shqipëria do t'i transmetojë Autoriteti Evropian të Sigurisë Ushqimore (EFSA) të gjitha të dhënat nga viti i kaluar, duke përfshirë rezultatet e përputhshme të metodave *screening* ku nuk janë kryer analiza konfirmuese, të mbledhura sipas planeve të kontrollit të përmendura në nenin 3.

Shqipëria verifikimin, rishikimin dhe pranimin përfundimtar të të dhënave në sistemet e depozitimit në EFSA do t'i dorëzojë deri më 31 gusht të çdo viti.

ANEKSI I

FREKUENCA MINIMALE E KAMPIONIMIT NË KUADËR TË PLANIT KOMBËTAR TË KONTROLLIT TË PRODHIMIT MBËSHTETUR MBI RISKUN (SIPAS PËRSHKRIMEVE TË NENIT 4, GERMA “C”)

Numri minimal i kampioneve është si vijon:

	<i>Frekuenca e kampionimit – substancat e grupit A</i>
Gjedhë	Minimumi 0.25% e kafshëve të therura (minimumi 25% e kampioneve duhet të merret nga kafshët e gjalla në fermë dhe minimumi 25% e kampioneve duhet të merren në thertore).
Të imta (dhen – dhi)	Minimumi 0.01% e kafshëve të therura për secilin lloj.
Derra	Minimumi 0.02% e kafshëve të therura.
Kuaј	Minimumi 0.02% e kafshëve të therura.
Shpendë	Për secilën kategori shpendësh (brojlera/zogj mishi, pula pjellëse në fund të ciklit, gjela deti, shpendë të tjera) minimumi 1 kampion për 400 ton prodhim vjetor (peshë e therur).
Akuakulturë (peshk, krostace dhe produkte të tjera të akuakulturës)	Minimumi 1 kampion për 300 tonë prodhim vjetor të akuakulturës për 60.000 tonët e parë të prodhimit dhe në vijim 1 kampion shtesë për çdo 2.000 tonë të tjera shtesë.
Qumësht lope, deleje dhe dhie	Minimumi 1 kampion për 30.000 tonë prodhim vjetor qumështi për secilin prej llojeve.
Vezë pule dhe vezë të tjera	Minimumi 1 kampion për 2.000 tonë prodhim vjetor të vezëve për secilin lloj.
Lepuj, kafshë të egra/gjuetie në mbarështim, zvarranikë dhe insekte	Minimumi 1 kampion për 100 tonë prodhim vjetor (peshë e therur) të lepujve, kafshëve të egra të mbarështuara ose reptilëve për 3.000 tonët e parë të prodhimit dhe 1 kampion shtesë për çdo 1.000 tonë të tjera shtesë. Minimumi 1 kampion për 25 tonë prodhim vjetor të insekteve.
Mjaltë	Minimumi 1 kampion për 50 tonë të prodhimit vjetor për 5.000 tonët e parë të prodhimit dhe në vijim 1 kampion shtesë për çdo 500 tonë të tjera shtesë.
Zorrë	Minimumi 1 kampion për 300 tonë prodhim vjetor.

	<i>Frekuenca e kampionimit – substancat e grupit B</i>
Gjedhë	Minimumi 0.10% e kafshëve të therura.
Të imta (dhen – dhi)	Minimumi 0.02% e kafshëve të therura për secilin lloj.
Derra	Minimumi 0.02% e kafshëve të therura.
Kuaј	Minimumi 0.02% e kafshëve të therura.
Shpendë	Për secilën kategori shpendësh (brojlera/zogj mishi, pula pjellëse në fund të ciklit, gjela deti, shpendë të tjera) të paktën 1 kampion për 500 tonë prodhim vjetor (peshë e therur).
Akuakulturë (peshk, krostace dhe produkte të tjera të akuakulturës)	Minimumi 1 kampion për 300 tonë prodhim vjetor të akuakulturës për 60.000 tonët e parë të prodhimit dhe në vijim 1 kampion shtesë për çdo 2.000 tonë të tjera shtesë.
Qumësht lope, deleje dhe dhie	Minimumi 1 kampion për 30.000 tonë prodhim vjetor qumështi për secilin prej llojeve.
Vezë pule dhe vezë të tjera	Minimumi 1 kampion për 2.000 tonë prodhim vjetor të vezëve për secilin lloj.
Lepuj, kafshë të egra të mbarështuara, reptilë dhe insekte	Minimumi 1 kampion për 50 tonë prodhim vjetor (peshë e therur) të lepujve, kafshëve të egra të mbarështuara ose reptilëve për 3.000 tonët e parë të prodhimit dhe 1 kampion shtesë për çdo 500 tonë të tjera shtesë. Minimumi 1 kampion për 25 tonë prodhim vjetor të insekteve.
Mjaltë	Minimumi 1 kampion për 50 tonë të prodhimit vjetor për 5.000 tonët e parë të prodhimit dhe në vijim 1 kampion shtesë për çdo 500 tonë të tjera shtesë.

Dispozita plotësuese

a) Nëse është e nevojshme për verifikimin e përputhshmërisë me legjislacionin kombëtar për përdorimin e substancave farmakologjikisht aktive të ndaluara ose të paautorizuara, AKVMB-ja mund të marrë kampione në ushqimet për kafshë, ujin e pijshëm nga kafshët ose matrica a të tjera ose në ambientin përkatës dhe t'i përllogarisë në arritjen e frekuencave minimale të kampionimit, sipas përshkrimeve të këtij aneksi.

b) Kontrollat mbi kombinimet e secilit nëngrup të substancave të grupit A dhe grupit të produkteve të përshkruara nga aneksi II, të urdhrit nr. 85, datë 17.2.2023, kryhen çdo vit mbi të paktën 5% të kampioneve të marra, në përputhje me kërkesat e kësaj tablele të këtij aneksi për atë grup produktesh. Kjo përqindje minimale nuk zbatohet për zorrët dhe as për grupin A, paragrafi 3, germa “F”, për të gjitha grupet e produkteve.

c) Për substancat e grupit B, përzgjedhja e substancave specifike që i nënshtrohen kontrollit brenda secilit grup të substancave vendoset në bazë të kriterëve të listuara në aneksin II të urdhrit nr. 85, datë 17.2.2023.

d) Brenda grupit “Gjedhë, dhen dhe dhi” kampionet merren nga të gjitha llojet e kafshëve, duke mbajtur parasysh vëllimin e prodhimit përkatës për secilin lloj. Kampionimi i përket qoftë kafshëve të destinuara për prodhimin e qumështit dhe atyre të destinuara për prodhimin e mishit.

e) Brenda grupit “Shpendë” merren kampione nga pulat e mishit, pulat në fund të periudhës së prodhimit të vezëve, gjela deti dhe shpendë të tjerë, duke mbajtur parasysh vëllimin e prodhimit përkatës.

f) Brenda grupit “Akuakultura” merren kampione nga llojet e peshkut të ujit të ëmbël dhe të ujit të detit, duke mbajtur parasysh vëllimin e prodhimit përkatës.

g) Nëse ka arsye të dyshohet se janë përdorur substanca farmakologjikisht aktive në produktet e tjera të akuakulturës, këto lloje të akuakulturës përfshihen në planin e kampionimit në raport me prodhimin e tyre si kampione shtesë përkundrejt atyre të marra për produktet e peshkut të kultivuar.

h) Merret një numër nevojshëm i kampioneve të synuara për të arritur frekuencën e përcaktuar të marrjes së kampioneve. Për të arritur këtë merret parasysh numri i kafshëve subjekt i kampionimit ose i grupit të kafshëve që do të mund të trajtohen në një grup (p.sh. peshku) pavarësisht nga numri i kontrolleve të kryera për çdo kampionim.

i) Kur substancat që u përkasin grupeve A dhe B analizohen në një kampion të vetëm që vjen nga një kafshë e vetme, ky kampion mund të merret në konsiderate për qëllimet e realizimit të frekuencës minimale të kampionimit për të dyja grupet (grupi A dhe grupi B), duke qenë se është e mundur të dokumentohet që kriteret e riskut për grupet A dhe B janë të njëjta. Nëse një kampion tjetër i një matrice tjetër merret nga e njëjta kafshë për analizimin e substancave të grupit A dhe/ose të grupit B, rezultati nuk merret në konsiderate për qëllimet e realizimit të frekuencës minimale të kampionimit. Megjithatë, atëherë kur substancat që i përkasin grupit A analizohen në një kampion, i cili vjen nga një matricë e një kafshë të vetme dhe substancat që i përkasin grupit B analizohen nga një kampion, i cili vjen nga tjetër matricë të së njëjtës kafshë, të dyja kampionet mund të përllogariten për qëllimet e realizimit të frekuencës minimale të kampionimit për të dyja grupet (grupi A dhe grupi B), duke qenë se është e mundur të dokumentohet që kriteret e riskut për grupin A dhe B janë të njëjta.

j) Kampionet e dyshuar të marra në vijim të masave të marra të ndjekjes së një rasti jokonform nuk përllogariten, me qëllim realizimin e frekuencës minimale të kampionimit të përshkruar në planin e bazuar në risk.

k) Për përllogaritjen e frekuencës minimale të kampionimit përdoren të dhënat e prodhimit më të fundit të disponueshme, të paktën të vitit të fundit ose së shumti të vitit të parafundit, nëse është e mundur për të reflektuar zhvillimet e njohura të prodhimit në momentin në të cilin të dhënat janë vënë në dispozicion.

l) Në rast se frekuenca e marrjes së kampioneve e llogaritur në përputhje me këtë aneks, përfaqëson më pak se pesë kampione në vit, kampionimi mund të kryhet një herë në dy vjet. Në rast se, brenda një periudhe dyvjeçare, nuk arrihet prodhimi që korrespondon me një minimum prej një kampioni, të paktën një mostër një herë në dy vjet do të analizohet, me kusht që prodhimi të bëhet për atë specie ose produkt brenda territorit të Republikës.

m) Kampionet e marra për qëllimet e planeve të tjera të kontrollit, që u përkasin analizave të substancave farmakologjikisht aktive dhe të mbetjeve të tyre (p.sh. në lidhje me kontaminantët, mbetjet e pesticideve etj.) mund të përdoren edhe për kontrollet mbi substancat farmakologjikisht aktive, me kusht që të respektohen kërkesat që u përkasin substancave farmakologjikisht aktive.

n) Kampionet e marra për planin e mbikëqyrjes së rastësishme do të shpërndahen në specie dhe produkte të ndryshme, sipas proporcionit që zënë në prodhimin dhe konsumin kombëtar, 25% e kampioneve do të analizohen për substancat e grupit A dhe 75% e kampioneve do të analizohen për substancat e grupit B.

**FREKUENCA MINIMALE E KAMPIONIMIT NË KUADËR TË PLANIT KOMBËTAR TË
IMPORTEVE NGA VENDET E TRETA BAZUAR NË RISK, SIPAS KËRKESAVE TË NENIT 6,
GERMA “C”)**

Frekuenca minimale e kampionimit mund të përdoret si pjesë e planit kombëtar me bazë risku të marrjes së kampioneve në pikat e kontrollit kufitar të hartuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Kontrollet e kryera, sipas masave emergjente dhe kontrolleve zyrtare të intensifikuara, sipas ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar, nuk do të llogariten në arritjen e frekuencave minimale të kampionimit të përcaktuara në këtë aneks.

Kontrollet e produkteve ushqimore të importuara nga vende me të cilat janë lidhur marrëveshje për njohjen reciproke të kontrolleve fizike, nuk përllogariten për qëllimet e realizimit të frekuencës minimale të kampionimit sipas kërkesave të këtij aneksi.

Numri minimal i kampioneve është si vijon:

	<i>Frekuenca e kampionimit për lëndët e grupit A dhe të grupit B</i>
Gjedhë (përfshirë kafshët e gjalla, mishin, mishin e grirë, mishin e ndarë në mënyrë mekanike, përgatitjet e mishit dhe produktet me bazë mishi)	Minimumi 7% të ngarkesave të importuara
Të imta (dhen/dhi) (përfshi kafshët e gjalla, mishin, mishin e grirë, mishin e ndarë në mënyrë mekanike, përgatitjet e mishit dhe produktet me bazë mishi)	Minimumi 3% të ngarkesave të importuara
Derra (përfshirë kafshët e gjalla, mishin, mishin e grirë, mishin e ndarë në mënyrë mekanike, përgatitjet e mishit dhe produktet me bazë mishi)	Minimumi 3% të ngarkesave të importuara
Kuaj (përfshirë kafshët e gjalla që do të theren për konsum për njerëz, mishin, mishin e grirë, mishin e ndarë në mënyrë mekanike, përgatitjet e mishit dhe produktet me bazë mishi)	Minimumi 3% të ngarkesave të importuara
Shpendë (përfshirë kafshët e gjalla, mishin e shpendëve dhe produktet me bazë mishi shpendësh)	Minimumi 7% të ngarkesave të importuara
Akuakulturë (peshk, krostace dhe produkte të tjera të akuakulturës)	Minimumi 7% të ngarkesave të importuara
Qumësht (përfshirë qumështin e freskët të papërpunuar, produktet e bulmetit, kulloshtren dhe produktet me bazë kulloshtre të të gjitha llojeve të kafshëve që milen)	Minimumi 7% të ngarkesave të importuara
Vezë (përfshirë vezët dhe produktet e vezëve nga të gjitha llojet e shpendëve)	Minimumi 12% të ngarkesave të importuara
Lepuj, kafshë të egra të mbarështuara, reptilë dhe insekte (përfshirë kafshët e gjalla, mishin dhe produktet me bazë mishi të llojeve të kafshëve të përmendura dhe produktet me origjinë nga këto lloje)	Minimumi 12% të ngarkesave të importuara
Mjaltë (përfshirë mjaltin dhe produktet e tjera të apikulturës)	Minimumi 7% të ngarkesave të importuara
Zorrë	Minimumi 2% të ngarkesave të importuara

Dispozita të tjera shtesë

a) Për përllogaritjen e frekuencave minimale të kampionimit të listuara në këtë aneks përdoren të dhënat me të fundit, të paktën të vitit të fundit ose së shumti të vitit të parafundit, që u përkasin ngarkesave që hyjnë në vend nëpërmjet pikave të kontrollit kufitar.

b) Në rastin në të cilin numri i ngarkesave që hyjnë në vend në një periudhë kohore prej tri vitesh është më i vogël se numri i ngarkesave nga të cilat mund të realizohet marrja e një kampioni, kampionimi mund të kryhet një herë në dy ose tre vjet.

c) Kampionet e marra për qëllimet e kontrolleve zyrtare që u përkasin analizave të substancave farmakologjikisht aktive dhe mbetjeve të tyre (p.sh., në lidhje me kontaminantët ose mbetjet e pesticideve etj.) mund të përdoren edhe për kontrollet e substancave farmakologjikisht aktive, me kusht që respektohen kontrollet mbi farmakologjikisht aktive.